



KOSTT Transmission Grid Strengthening Project

Vendndodhja:	KOSOVA
ID i Projektit:	55387
Sektori i Biznesit:	Electric Bulk Power Transmission and Control
Lloji i Njoftimit:	Publik
Kategoria Mjedisore:	B
Data e aprovimit:	23 Shtator 2026
Statusi:	Explorues
Data e publikimit:	30 Shtator 2025

Përshkrimi i Projektit

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po shqyrton mundësinë e dhënies së një huaje korporative deri në 29 milionë euro për ndërmarrjen publike Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut J.S.C. (KOSTT). Qëllimi i huasë është financimi i rehabilitimit dhe përmirësimit të disa nënstacioneve, transformatorëve dhe linjave të transmisionit të energjisë elektrike, me synim forcimin e stabilitetit të rrjetit kombëtar të tensionit të lartë (HV) dhe lehtësimin e ndjeshëm të integritetit të kapaciteteve të reja të burimeve të energjisë së rinovueshme (RES), si dhe digjitalizimin e aktiviteteve të Operatorit të Tregut. Investimi do të mbështetet gjithashtu me një grant investimi prej 5 milionë eurosh nga Danimarka. Projekti përfiton gjithashtu nga programi i garancisë Fondi Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm (EFSD+) për mbulimin nga humbjet e pritshme (first loss risk cover). Programi kontribuon në tranzicionin e ekonomive në Fqinjësinë Evropiane (European Neighbourhood) duke mbështetur investime të qëndrueshme në tranzicionin energjetik.

Objektivat e Projektit

Projekti do të fuqizojë ndjeshëm rrjetin e energjisë elektrike të Kosovës, duke rritur kapacitetin e tij për të integruar kapacitete shtesë të energjisë së rinovueshme në sistem. Ai do të mundësojë lidhjen e kapaciteteve të planifikuara të prodhimit nga burimet e rinovueshme që janë aktualisht në zhvillim dhe do të zvogëlojë rrezikun e kufizimit të prodhimit të energjisë së rinovueshme (*curtailment*). Projekti do të mbështesë funksionimin e tregut të energjisë elektrike. Për më tepër, Projekti do ta ndihmojë kompaninë në përafrimin me praktikat më të mira ndërkombëtare në lidhje me sigurinë dhe fleksibilitetin e funksionimit të sistemit. Përmes zbatimit të platformës Electricity Market Management System (EMMS), Projekti do të përmirësojë menaxhimin e energjisë, monitorimin e sistemit dhe efikasitetin e operacioneve të kompanisë në tregun e energjisë elektrike.

Ndikimi I Tranzicionit

ETI vlerësimi: 65

Projekti është në përputhje me Strategjinë e BERZH për Kosovën, duke vënë theksin në promovimin dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të energjisë. Ndikimi i pritshëm i tranzicionit të projektit do të bazohet në dy kualitete: 'Green' dhe 'Resilient'. Projekti do të sigurojë rehabilitimin e nënstacioneve dhe zëvendësimin e transformatorëve si dhe linjave të transmetimit, gjë që do të çojë në përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe rritjen e besueshmërisë së sistemit. Projekti do të mundësojë integrimin e kapaciteteve të reja të burimeve të rinovueshme të energjisë në të gjithë vendin.

Informacion mbi Klientin

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU – KOSTT SHA

KOSTT, Operator i Transmetimit, Sistemit dhe Tregut J.S.C, është një shoqëri aksionare në Kosovë, në pronësi 100% të Republikës së Kosovës dhe të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Ministrisë së Ekonomisë. Përgjegjësitë kryesore përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të Kosovës dhe të tregut. KOSTT është gjithashtu blerësi i energjisë nga burimet e ripërtrishme.

Përmbledhje e Financimit nga BERZH

EUR 25,000,000.00

Kosto totale e projektit

EUR 42,800,000.00

Shtesë

Duke bashkuar financimin afatgjatë thelbësor dhe mbështetjen teknike, kjo nismë krijon një paketë gjithëpërfshirëse që avancoi tranzicionin e gjelbër të vendit dhe rajonit. Përfshirja e BERZH

lehtëson aksesin në financime që përndryshe nuk do të ishin të disponueshme në tregun lokal dhe mbështet adoptimin e praktikave më të mira ndërkombëtare për stabilitetin dhe fleksibilitetin e sistemit. Gjithashtu, ekspertiza e mbështetur nga Banka do të ndihmojë KOSTT-in në forcimin e menaxhimit mjedisor dhe social, prokurimit dhe kapaciteteve të zbatimit.

Përmbledhje Mjedisore dhe Sociale

Kategoria B (ESP 2019)

Projekti përfshin rehabilitimin dhe fuqizimin e rrjetit të transmetimit të KOSTT-it përmes përmirësimit të nënstacioneve kryesore 110 kV, zëvendësimit të transformatorëve të vjetërsuar, rehabilitimit të pajisjeve të transmetimit, si dhe ndërtimit të një kablloje të re nëntokësore me qark të dyfishtë, me gjatësi 5,2 km, ndërmjet nënstacioneve Prizren 1 dhe Prizren 2. Investimi do të përmirësojë stabilitetin e rrjetit, do të reduktojë humbjet teknike, do të forcojë sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe do të mbështesë integrimin e kapaciteteve të prodhimit nga burimet e ripërtëritshme të energjisë. Aktivitetet e Projektit nuk ndodhen brenda ose në afërsi të zonave të mbrojtura të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.

Vlerësimi i kujdesit të duhur mjedisor dhe social (ESDD), i cili përfshinë një vlerësim të kompanisë dhe shqyrtimin e përdorimit të propozuar të fondeve, identifikoi një sërë çështjesh mjedisore të trashëguara që lidhen me asetet ekzistuese të KOSTT-it. Këto përfshijnë rrjedhje të vajit të transformatorëve, mungesë ose pamjaftueshmëri të sistemeve dytësore të mbajtjes së rrjedhjeve, mungesë ose funksionim joefektiv të separatorëve vaj-ujë, përdorimin e rezervuarëve nëntokësorë për mbledhjen e ujërave të rrjedhjes të kontaminuara, si dhe mangësi në menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme. Rreziqet e mundshme mjedisore përfshijnë vajra që përmbajnë PCB, materiale që përmbajnë asbest në objektet e vjetra, menaxhim jo të përshtatshëm të mbetjeve të baterive, si dhe ndotje të lokalizuar të tokës si pasojë e rrjedhjeve historike.

KOSTT-i aktualisht nuk operon me një Sistem të formalizuar të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMS), ndonëse ka të vendosura një sërë procedurash dhe praktikash mjedisore dhe sociale. ESDD-ja identifikoi disa boshllëqe në raport me Kërkesat e BERZH-it të Performancës (PR), duke përfshirë nevojën për krijimin e një ESMS-je formal, forcimin e menaxhimit të materialeve dhe mbetjeve të rrezikshme, përmirësimin e mbikëqyrjes së kontraktorëve, formalizimin e mekanizmave të ankesave për punëtorët dhe komunitetin, përmirësimin e gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave, si dhe përditësimin e proceseve të angazhimit me palët e interesuara.

Për adresimin e këtyre mangësive është dakorduar një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social (ESAP), i cili përfshin masa për rehabilitimin dhe instalimin e separatorëve vaj-ujë, menaxhimin e PCB-ve, menaxhimin e asbestit dhe mbetjeve të rrezikshme, rehabilitimin e zonave të kontaminuara, forcimin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe përmirësimin e sistemeve të mbrojtjes nga zjarri.

Ndikimet kryesore mjedisore dhe sociale lidhen me aktivitetet e ndërtimit dhe pritet të jenë të përkohshme dhe të kufizuara në zonat e projektit. Këto përfshijnë zhurmën, pluhurin, pengesat e përkohshme në trafik, kufizimet e përkohshme të qasjes dhe shqetësimet për komunitetin. Rreziqet kryesore për shëndetin dhe sigurinë në punë lidhen me punimet elektrike, ngritjen dhe transportimin e ngarkesave të rënda, zëvendësimin e transformatorëve, menaxhimin e kontraktorëve dhe rreziqet nga zjarri që lidhen me infrastrukturën e vjetërsuar dhe pajisjet e mbushura me vaj. Këto ndikime do të menaxhohen përmes zbatimit të planeve të menaxhimit të ndërtimit, të përgatitura nga kontraktorë kompetentë dhe të prokuruar në përputhje me kërkesat e BERZH-it, si dhe përmes masave të përcaktuara në ESAP.

Gjatë fazës së operimit, Projekti pritet të zvogëlojë humbjet në rrjet, të përmirësojë besueshmërinë dhe të rrisë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë. Ndikimet në biodiversitet pritet të jenë të papërfillshme, pasi punimet do të kufizohen në nënstacionet ekzistuese dhe korridoret ekzistuese të infrastrukturës. Nuk parashikohen ndikime në zonat e mbrojtura, habitatet kritike ose asetet e trashëgimisë kulturore. Për punimet e gërmimit që lidhen me instalimin e kabllor do të zbatohet Procedura për Gjetjet e Rastësishme (Chance Finds Procedure).

Zonat përreth nënstacioneve janë kryesisht rezidenciale, komerciale dhe bujqësore. Bazuar në informacionin në dispozicion dhe në vëzhgimet në terren, nuk janë identifikuar ankesa të rëndësishme historike, incidente të lidhura me shëndetin dhe sigurinë e komunitetit apo konflikte të përdorimit të tokës që lidhen me objektet e KOSTT-it. Shqyrtimi i mediave identifikoi protesta të sindikatave në vitin 2025 lidhur me pagat dhe kushtet e punës. Menaxhmenti i KOSTT-it vazhdon të angazhohet me përfaqësuesit e punëtorëve. ESAP-ja kërkon krijimin e një mekanizmi formal dhe të qasshëm të ankesave për punëtorët, me qëllim identifikimin dhe zgjidhjen në kohë të çështjeve në vendin e punës.

Testimi për PCB-të konfirmoi përqendrimet nën pragun që do të aktivizonte kërkesa të veçanta për menaxhim sipas Konventës së Stokholmit. Megjithatë, hetimet e kufizuara në terren identifikuan tokë të kontaminuar me PCB në nënstacionin Gjakova 2, me përqendrimet që tejkalojnë vlerat e zbatueshme të ndërhyrjes. Rreziku mjedisor në këtë lokacion është vlerësuar si i lartë. Hetimet e mëtejshme dhe masat e rehabilitimit janë përfshirë në ESAP. Nuk është identifikuar ndotje e ujërave nëntokësore. Bazuar në informacionin aktualisht në dispozicion, kostot e rehabilitimit pritet të mbulohen nga kontingjencat e Projektit, me kusht që kjo të konfirmohet pas përfundimit të hetimeve të detajuara në terren.

Nuk parashikohet zhvendosje fizike ose zhvendosje ekonomike, pasi nënstacionet ndodhen në toka të përdorura nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (TSO) dhe pjesa më e madhe e punimeve do të kryhet brenda gjurmës ekzistuese të objekteve operative. Kufizime të përkohshme të qasjes dhe të drejta të kufizuara të servitutit mund të kërkojnë përgjatë korridorit të kabllor Prizren 1–Prizren 2 dhe do të menaxhohen në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe Kërkesën e Performancës 5 të BERZH-it (PR5). Ndikimet e mundshme tek përdoruesit e tokës do të vlerësohen më tej gjatë projektimit të detajuar dhe përcaktimit përfundimtar të trasesë. Kontraktorët do të zbatojnë procedurat për hyrjen në tokë dhe daljen nga toka, ndërsa çdo ndikim i përkohshëm ose i

përhershëm lidhur me tokën do të menaxhohet përmes një Plani për Blerjen e Tokës në përputhje me kërkesat e BERZH-it, sipas nevojës.

Në përgjithësi, ESDD-ja arriti në përfundimin se Projekti do të sjellë përfitime të konsiderueshme mjedisore dhe sociale përmes përmirësimit të stabilitetit të rrjetit, zvogëlimit të humbjeve teknike dhe rritjes së mundësive për integrimin e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Rreziqet e identifikuar janë tipike për projektet e rehabilitimit të rrjeteve të transmetimit dhe konsiderohen të menaxhueshme përmes zbatimit të ESAP-it dhe respektimit të Kërkesave të Performancës së BERZH-it. Me kusht që masat e dakorduara të zbatohen, Projekti pritet të jetë në përputhje me kërkesat përkatëse kombëtare dhe të BERZH-it dhe konsiderohet i pranueshëm për financim nga Banka.

KOSTT-i do të mbështetet nga një Njësi e Dedikuar për Zbatimin e Projektit (PIU), e cila do të ndihmojë në zbatimin e ESAP-it, zhvillimin e aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesuara dhe funksionimin e mekanizmit të ankesave në nivel të Projektit.

Informacioni mjedisor dhe social që do të bëhet publik do të përfshijë një Përmbledhje Jo-Teknike (NTS) dhe një Plan të Angazhimit të Palëve të Interesuara (SEP). Banka do të monitorojë zbatimin e ESAP-it dhe të planeve përkatëse të menaxhimit dhe do të kryejë aktivitete mbikëqyrëse, duke përfshirë vizita në terren, sipas nevojës.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi përmes Grantit

Projekti do të zbatohet në përputhje me Politikën dhe Rregullat e Prokurimit të BERZH-it (PP&R). BERZH-i po siguron fonde për asistencë teknike për të mbështetur KOSTT-in në përgatitjen e Projektit në aspektet mjedisore dhe sociale, teknike dhe ligjore. Për më tepër, Banka po siguron edhe financim për asistencë teknike për të mbështetur KOSTT-in në përgatitjen e një studimi fizibiliteti për projektimin e një platforme digjitale në kuadër të funksionit të Operatorit të Tregut pranë KOSTT-it. Ky financim synon të lehtësojë zbatimin e Projektit dhe të forcojë kapacitetet institucionale të KOSTT-it. Asistenca teknike do të financohet bashkërisht nga Fondi Danez për Bashkëpunim, fondet e brendshme të BERZH-it dhe Fondi Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm Plus (EFSD+).

Informacion Kontaktues i Kompanisë

Shaban Neziri

Shaban.neziri@kostt.com

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e

transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.

